

ÇLIROHUNI NGA PRANGAT

Ka shumë pajisje dhe multi-media, të cilat ruajnë lirinë tonë. Ne mund të zgjedhim të jetojmë pa pranga dixhitale. Mund të blejmë media, të cilat mund t'i përdorim përgjithmonë, në çdo format të zgjedhur nga ne. Me pak kërkim, mund të zgjedhim pajisje, të cilat nuk na lidhin detyrimisht me formate të caktuara.

Në pikëpamjen politike, ne duhet të vendosim nëse sistemi i licensimit duhet t'i shërbejë vetëm botuesve apo duhet t'i shërbejë shoqërisë në tërësi dhe gjeneratave të ardhshme. Në vend të parandalimit të riprodhimeve dixhitale, ne duhet të mbështesim modele biznesi, që respektojnë të drejtat tonë themelore të lirisë dhe privatësisë. Ne duhet të ndërtojmë një sistem licensimi, nga i cili do të përfitojë gjithkush, jo vetëm interesat e ngushta të bizneseve.

Çlirim i nga dispozitat që kushtëzojnë qytetarët nga përdorimi i përbajtjes ligjërisht të blerë është një hap i parë i rëndësishëm.

Më shumë informacion për DRM dhe rrëth lirisë në botën dixhitale, mund të gjeni në:

- Defective by design
<http://defectivebydesign.org>
- drm.info
<http://drm.info>
- Wikipedia
http://en.wikipedia.org/wiki/Digital_rights_management
- EDRI
<http://edri.org/search/DRM>




Menaxhimi i Kufizimeve Dixhitale (DRM*)

Bota e çuditshme, e thyer e Menaxhimit të Kufizimeve Dixhitale



<https://fsfe.org>



DIGITALE
GESELLSCHAFT

<https://digitalegesellschaft.de>

Free Software Foundation Europe e.V.
Schönhauser Allee 6/7, 10119 Berlin
office@fsfe.org
V.i.S.d.P. Matthias Kirschner

Digitale Gesellschaft e.V.
Sophienstraße 5, 10178 Berlin
[@digiges](mailto:info@digitalegesellschaft.de)

Ky tekst është shkruar nga punonjës dhe vullnetarë të
Free Software Foundation Europe(FSFE) dhe European Digital Rights Initiative (EDRI).

Free Software Foundation Europe (FSFE) është një organizatë joftimprurëse, e dedikuar në promovimin e Programave të Lira, me qëllim përfundimtarit të ndërtuar një shoqëri të lirë dixhitale.

Digitale Gesellschaft e.V. është një shoqatë e regjistruar gjermane, e dedikuar në punën e të drejtave civile dhe mbrotjes së konsumatorit në drejtim të politikave të internetit.

Ky dokument është publikuar nën licensën Creative Commons (CC BY-SA 4.0)

Ilustrimi i kopertinës: CC BY-SA 3.0
Brendan Mruk and Matt Lee

Ilustrimi i "trekëndëshit lajmërues": CC BY-SA 2.5
AlfredoDanielRezinovsky

Dëshironi të shikoni **filmat e tua ligjërisht të blerë** në pajisje të ndryshme? Dëshironi të bëni **kopje të DVD-ve** tua? Apo dëshironi të ktheni librat e tua dixhale në **formate të ndryshme**?

* = DRM eshte akronimi i Digital Restrictions Management (Menaxhimi i Kufizimeve Dixhitale)



Sistemet e Menaxhimit të Kufizimeve Dixhitale(DRM) vendosin kufizime në të drejtat tua përfundimtarit të bëre të gjitha këto gjëra. Librat dixhitale apo filmat mund të mos funksionojnë në tërësi, nëse pala shítëse falimenton apo nuk mirëmban më një sistem të caktuar DRM.

ÇFARË ËSHTË DRM-JA?

Menaxhimi i Kufizimeve Dixhitale (DRM) është çdo lloj teknologjie, e cila është e ndërtuar brenda një produkti apo shërbimi elektronik, me qëllim kufizimin e gamës së përdorimeve pas blerjes. Ajo është e projektuar të parandalojë konsumatorët nga të përdorurit e teknologjisë dixhitale në mënyrat që nuk korrespondonjë me axhendën e biznesit të një ofruesi përbajtje apo prodhuesi pajisjesh.

Shpesh, kjo teknologji u pengon individëve kryerjen e akteve që janë plotësisht të ligjshme, duke mos na dhënë mundësinë të miksojmë këngë që kemi blerë ligjërisht, apo të japimhua librin dixhital një shoku. Edhe backup-et mund të kufizohen. Teknologjitet e Menaxhimit të Kufizimeve (DRM) heqin të drejtat dhe liritet bazë në botën dixhitale.

Të gjithë sistemet DRM kanë një gjë të përbashkët: u jepin kontroll bizneseve mbi gjëra që ne, zotëruesit, duhet të ishim në kontroll. Psh. bizneset vendosin sa shpesh mund të shikojmë filmat për të cilat kemi paguar dhe cilat janë formatet që mund të lexojmë në lexuesin tonë dixhital.

Edhe nëse ne gjejmë një mënyrë për të shmangur DRM për t'u liruar nga këto kufizime, Direktiva e Komisionit Europian mbi Të drejtat e Autorit Në Shoqërinë e Informacionit e bën atë ilegal. Kjo Direktivë dëshmon se ligjet e ngjashme ndihmojnë në ruajtjen e modeleve të vjetër uara tashmë të biznesit të botimeve (lajmeve, literaturës, muzikës, filmave dhe informacioneve të tjera), për shembull, duke kufizuar të drejtën e kopjës private, në një botë ku, thaujse kushdo ka pajisje të ndryshme multimediale.

Si pasojë, pajisjet elektronike shpesh ndërtohen për të genë jocilësore, duke ndaluar përdorimin e kapacitetit të plotë të teknologjisë, duke na ndaluar përdorimet që ishin plotësisht të pakundërshtueshme, përpresa se progresi teknologjik t'u jepte mjetet bizneseve për t'u ndaluar.



KUFIZIME DIXHITALE APO TË DREJTA QYTETARE?

Ka shumë sisteme të ndryshme DRM në treg. Këto sisteme janë të papajtueshme me njëritjetrin, duke e bërë akoma më të vështirë përdorimin e përbajtjes ligjërisht të blerë nga qytetarët.

Nëse blejmë filma nga kompania Apple, ne duhet të përdorim programet e Apple për t'i parë ato dhe, që nga ky moment, ne nuk jemi më të lirë të zgjedhim produkte apo shërbime konkurrente. Kjo dobëson konkurencën dhe kufizon inovacionin.

Personave me aftësi të kufizuara shpesh u mohohet mundësia për të përdorur media, ngaqë DRM-ja ua pengon shndërrimin e përbajtjes në formate të përdorshëm pavarësisht aftësive të kufizuara. Për shembull, botues librash protestuan kundër aftësisë që pajisjet e e-librave nga Amazon të shndërron tekst në të folur. Amazon iu përul vullnetit të botuesve dhe për shumë libra e çaktivizoi mekanizmin nga-teknologjia-folur, çka do të thotë që të verbit thjesht s'do të janë në gjendje t'i lexojnë këta libra.

Menaxhimi i Kufizimeve Dixhitale (DRM) mund të ndryshojë gjithashu mënyrën se si zbatohen ligjet dhe rregulloret: Shfrytëzimi i përjashtimeve që lejojnë ligjet e licensave është bërë i pamundur, sepse sistemet DRM nuk janë aspak fleksibël. Për shembull, citimi i materialit të licensuar është një akt i ligjshëm; sistemet DRM kufizojnë çdo lloj kopjimi, edhe ato që përdoren si citime. Kjo do të thotë se ne duhet të shkruajmë një për një çdo fjalë, duke humbur kështu avantazhet e kopjimit dixhital.

HUMBJA E TRASHËGIMISË DIXHITALE

Burimet e shkruara të njjerëzve datojnë qindra e mijëra vite më parë, por dokumentat dixhitale janë shkruar në materiale delikate, si CD apo memorie flash. Zakonisht, këto pajisje prishen pas disa vitesh. Nëse sistemet e Menaxhimit të Kufizimeve Dixhitale lidhin kulturën tonë bashkëkohore (librat, muzikën apo filmat) me këto pajisje, ajo do të humbasë bashkë me mediumin në të cilin janë ruajtur.

Ndërkohë që një bllokim i tillë i materialeve kulturore është një problem i madh për përdorimin privat të tyre, është një problem akoma më i madh bllokimi i materialit për librari, arkivat, muzetë dhe institucionet tjetra. Informacioni po kthehet në formate dixhitale sa vjen e më shumë, ndërkohë që ky informacion ruhet, shpërndahet dhe duhet të jetë i kopjuar. Për më tepër, sistemet DRM zgjasin për aq kohë sa kompanitë i shesin ato. Kur një sistem DRM zhduket, përbajtja bllokohet përgjithmonë.

Ndërkohë që librari dhe arkivat ruanin njohuritë tona kulturore për shekuj me radhë, ato tashmë janë të detyruar të shpenzojnë një shumë të konsiderueshme parash publike në materiale, që do të bëhen të palexueshme në pak vite; pasuria e burimeve kulturore, historike dhe edukative do të humbasin. Kërkues në të ardhmen mund të pyesin veten pse shoqëria e sotme bllokoi kulturën nga vjetvetja.

SPIUNI NË XHEPIN TUAJ

DRM i ofron prodhuesve të pajisjeve, kompanive të programeve dhe botuesve akses tek pajisjet tona. Këto biznese vendosin se si të përdorim përbajtjen dixhitale dhe marrin aprosimativ nga konsumatorët e tyre nëpërmjet një mekanizmi "merr ose lë", nëpërmjet termave dhe kushteve që aplikojnë. Këto zakonisht janë materiale shumë të gjata dhe të shkruara në mënyrë të tillë që të mos kuptohen nga qytetarë të thjeshtë. Duke thënë këtë, shumë njerëz nuk i lexojnë asnjëherë; por edhe nëse i

lexojnë dhe nuk bien dakord, bëhet shumë i vështirë refuzimi i njësies që duan të përdorin. Në vitin 2009, kompania Amazon ndërrhi në mënyrë elektronike tek lexuesit e librave dixhitale, të cilët ishin klientë të tyret, duke fshirë librat që kompania kishte shitur gabimisht. Ndër librat e fshirë ishte edhe libri 1984, i autorit George Orwell, një libër mbi një botë, ku ekzistonte një pajisje e quajtur 'vrima e kujtesës'. Në këtë pajisje, qeveria bënte që materialet e paautorizuara të zhdukeshin përgjithmonë. Amazon, më vonë, premtoi se nuk do ta përdorte më këtë metodë, përvëç rastit kur do të urdhërohej nga një qeveri. Ironia e situatës nuk mund të dukej më qartë.

Pala shitëse mund të gjurmojë se çfarë muzikë dëgjojmë dhe çfarë librash levojmë. Ne nuk kemi asnjë kontroll se ku ky informacion shkon kur lë pajisjen tonë.

KREATIVITET I SHFRENUAR

Sot, ne kemi akses në një sasi të paprecedent dijeje në format dixhital. Dija që kemi mbledhur dhe përmirësuar brez pas brezi është trashëgimia jonë kulturore. Projektet pa kufizime, si: Wikipedia dhe Free Software janë lider në shumë aspekte; ata dëshmojnë se çfarë mund të arrijmë kur dija lihet e lirë.

DRM është një përpjekje për të ruajtuar një model biznesi që po merr fund në moshën dixhitale dhe për të kufizuar konkurencën. Bizneset provojnë të modelojnë teknologjinë moderne bazuar në sistemin e vjetër, në të cilin bizneset kontrollojnë të gjithë përbajtjen. Kjo do të eliminonte shumë avantazhe të teknologjisë moderne.

As për ligjet e të drejtave të autorit nuk është arritur të ecin me kohën. Si botuesit, ashtu edhe qytetarët kërkojnë reformim të këtyre ligjeve, por me synime të ndryshme. Ne duhet të vendosim: Duhet të rehatojmë interesat e një grupi të vogël, por të zhurmshëm korporatash; duhet të lejojmë bizneset të përcaktojnë se ku janë limitet për shpërndarjen e dijes dhe kulturës nga ne apo janë implikimet morale dhe sociale të barrierave ligjore shumë serioze për t'u injoruar?